REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

D R A F T

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

KOMUNALE

2012 - 2014

Prill - Shtator 2011

Parashikimet

Buxheti për vitet 2012-2014 është përgatitur brenda Kornizës Afatmesme të zhvillimit komunal dhe në bazë të legjislacionit ekzistues. Përparësia kryesore e kësaj qasjeje është që pasojat e vendimeve të tanishme mbi politikat fiskale për vitet e ardhshme janë bërë të qarta.

Buxheti për vitin 2012-2014 respekton prioritetet e gjera të politikave Komunale.

Tiparet më të rëndësishme të këtij veprimi janë:

- Janë parashikuar vetëm të hyra modeste
- Është projektuar që rritja e moderuar në nivelin e investimeve kapitale të kompensohet me shkurtime në mallra e shërbime

Hyrje

Në rrethanat aktuale, buxheti komunal është planifikuar për periudhën buxhetore 2012 - 2014 në bazë të qarkores së parë buxhetore 2012/01 të lëshuar nga MF-i. Pasi që Buxheti është instrumenti kryesor në dispozicion i politikave komunale, Kuvendi komunal ka ndërmarrë procesin e planifikimit të buxhetit brenda Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB). Ky KAB ka për detyrë qasjen e përmbushjes së kërkesave që dalin nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike, Llogaridhënien, si dhe kërkesave të komuniteteve që jetojnë në territorin e KK Rahovec .

Kuvendi komunal i Rahovecit së pari ka zhvilluar qasje ndaj buxhet-it të vitit 2010, që më pas kishte mbështetur formulimin e buxhetit për vitin 2011 dhe parashikimin e buxhetit për periudhën 2012-2014. Strategjia buxhetore e Kuvendit komunal ishte artikuluar në dokumentin mbi politikat fiskale të komunës, të aprovuara nga Kuvendi komunal për 2011, pra vendimit mbi taksat dhe tarifat komunale që i ka ofruar supozimet kyçe në të cilat mbështetej zhvillimi i këtij veprimi. Që atëherë, KAB-i ka kaluar nëpër rishikime të njëpasnjëshme, për të marrë parasysh:

- rrjedhat reale të buxhetit të vitit 2011
- planin për buxhetin e vitit 2012-2014
- diskutimet në nivele të ndryshme të vendim-marrjes në takimet që janë bërë me drejtorët e drejtorive, komitetin për politikë dhe financa.
- Diskutimeve publike me komunitetet që janë pjesëmarrës në përpilimin e buxhetit të komunës etj.

Objektivat themelore të strategjisë afatmesme të dala nga diskutimet janë:

- Të ngrihet disiplina fiskale dhe që shpenzimet buxhetore të jenë të planifikuara brenda kornizës reale fiskale,
- Të kontribuohet për arritjen e qëndrueshmërisë fiskale,
- Të zbatohen politikat në mbështetje të reformave në procesin buxhetor,
- Të shtohet transparenca në vendim-marrje në lidhje me planifikimin e buxhetit
- Të përmirësohet cilësia e shpenzimeve publike
- Të mundësohet një parashikim më i madh në procesin buxhetor, duke u mundësuar kështu agjencive shpenzuese që të planifikojnë buxhetet e tyre shpenzuese gjatë periudhës afatmesme.

Kuvendi Komunal i Rahovecit me planin Strategjik ka përcaktuar prioritet, me qëllim që të bëjë ndërlidhjen e procesit të planifikimit të buxhetit në bazë të prioriteteve.

Prioritetet e buxhetit për vitet 2012-2014 do të jenë këto :

Prioriteti 1: Infrastruktura, për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen ekonomike, (Rregullimi i rrugëve, kanalizimeve të ujërave të zeza, ujësjellësit etj.).

Prioriteti 2: Efikasiteti në menaxhim, për të rritur në maksimum të ardhurat. Këto prioritete pasqyrojnë nevojën aktuale për zhvillim ekonomik, si dhe nevojën për arritjen e rezultateve sa më të larta nga aktivitetet e Qeverisë Komunale me burime të kufizuara të financimit që janë në dispozicion të komunave.

Prioriteti 3: Modernizimi i sistemit edukativ-arsimor duke u mbështetur në reformat që po bëhen në arsim.

Prioriteti 4: Përmirësimi i kujdesit në shëndetësi.

BUXHETIMI I ORIENTUAR KAH REZULTATET DHE PRIORITETET KOMUNALE

Ekzistojnë disa përparësi të financimit, të orientuara kah rezultatet që aplikohen në vendet më të zhvilluara dhe me traditë të gjatë të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, dhe më të rëndësishme janë:

- T'iu komunikojë shqyrtuesve dhe vendimmarrësve të buxhetit, rezultate që mund të priten të arrihen nga programet buxhetore,
- Duke bërë kërkesa buxhetore sipas qëllimeve dhe rezultateve që planifikohen të arrihen,
- Lehtësimin e vendimmarrjes nga organet kompetente për vendimmarrje,
- Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë në zbatimin e buxhetit

Synimet kryesore të Komunës së Rahovecit do të jenë:

- **Zhvillimi ekonomik**: Rindërtimi i infrastrukturës ekonomike të Rahovecit, shërbimeve publike dhe infrastrukturës së komunikacionit, modernizimi i politikave fiskale dhe mundësive për zhvillimin e biznesit, e me këtë edhe hapjen e vendeve të reja të punës dhe tërheqja e investimeve të huaja, që do të jenë në dobi të banorëve të komunës së Rahovecit.
- **Arsimi:** Modernizimi i sistemit arsimor dhe strukturës fizike në mënyrë që të gjithë fëmijët të përfshihen në arsim, për të pasur mundësinë që të bëhen qytetarë produktiv të komunës pas kryerjes së shkollimit
- **Shëndetësia:** Përmirësimi i ambientit dhe sistemit të kujdesit shëndetësor, në mënyrë që të gjithë banorët të jetojnë në një ambient të shëndoshë dhe të kenë një kujdes gjithëpërfshirës shëndetësor në pajtim me standardet ndërkombëtare.
- **Zhvillimi rural:** Re-vitalizimin e fshatrave në mënyrë që të sigurojë mundësi të qëndrueshme për prodhimtari të shtuar bujqësore dhe të shëndetshme. Sfida më e madhe që kemi përpara është zhvillimi i bujqësisë (vreshtaria dhe perimekultura), por edhe degët e tjera të bujqësisë. Duke i pasur parasysh mundësitë e vogla buxhetore të KK Rahovec, ne e kemi me prioritetet tona bujqësinë dhe në funksion të kësaj do të punojmë me përkushtim për sigurimin e burimeve të tjera financiare si: grande, kontakte dhe komunikim aktiv me MBPZHR, por edhe me donatorë të huaj dhe vendorë etj. Pra, bujqësia është në krye të prioriteteve të qeverisjes tonë dhe ne do të bëjmë konkretisht për motivimin, stimulimin, orientimin dhe do të jemi shumë aktiv që të gjejmë sa më shumë forma e mundësi për mbështetjen e këtij sektori strategjik, i cili drejtpërdrejt do të ndikoj në zhvillimin ekonomik dhe zbutjen e gjendjes sociale.

Kuvendi komunal planifikon të shfrytëzojë këto prioritete si udhërrëfyes në përgatitjen e buxhetit për vitet 2012-2014.

Ky dokument i KAB-it ka këtë përmbajtje siç vijon më poshtë:

- Thekson kahet kyçe fiskale në periudhën 2010 - 2011
- Supozimet themelore në të cilat mbështetet parashikimi i të hyrave dhe ndryshimet në politikat e të hyrave që pritet të rezultojnë në përmirësimin e grumbullimit të të hyrave

- Prezanton supozimet kryesore, në të cilat mbështeten projeksionet e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ekonomike.

KAB-i i prezantuar në formë të këtij dokumenti ofron sqarime për Buxhetin e Kuvendit Komunal të Rahovecit.

Kahet aktuale fiskale

Gjatë periudhës 2010 - 2011, buxheti i Komunës ka qenë i karakterizuar nga të hyrat e shpenzimet. Këto kategori kanë treguar një rritje për çdo vit. Këto rritje janë paraqitur në disa të hyra. Rritje të theksuar ka pasur në të hyrat vetjake të komunës e posaçërisht rritje ka pasur në tatimin në pronë, ndërsa tek të hyrat nga grandet qeveritare nuk kemi pasur rritje të madhe, por ka ndodhur që prej vitit në vit të ketë edhe rritje simbolike të të hyrave nga grandi qeveritar. Po ashtu kemi pasur ngecje në stafin e të punësuarve, e që është bërë në bazë të udhëzimeve nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Duke u bazuar në këto udhëzime, komunat kanë qenë të detyruara t'i respektojnë politikat që lidhen me stafin e të punësuarve. Gjatë planifikimit të stafit duhet pasur kujdes që mos të zvogëlohet stafi, i cili drejtpërdrejt është i lidhur me mësimdhënësit (stafi që është i angazhuar në mësimdhënie direkt) dhe tek stafi mjekësor.

Të hyrat

Gjatë periudhës 2010 – 2011 mbledhja e të hyrave në Komunë ka treguar rritje, posaçërisht të hyrat nga tatimi në pronë. Komuna varet nga të hyrat e grandit qeveritar dhe të hyrat vetjake

Komuna e Rahovecit mbledh të hyra vetjake, përfshirë gjobat e trafikut, taksat administrative, licencat, lejet e ndërtimit, qiratë dhe tatimin në pronë. Baza e këtyre të hyrave ka qenë edhe planifikimi i shpenzimeve kapitale, pasi në të shumtën e rasteve shpenzimet kapitale financohen kryesisht nga të hyrat vetjake. Një punë e madhe është bërë në zbatimin e tatimit në pronë në komuna, pasi mjetet e arkëtuara janë investuar në infrastrukturë, me synim përmirësimin e infrastrukturës. Nga kjo shihet se mjetet e arkëtuara nga komuniteti, kthehen në investime kapitale, ndërsa kjo ka hapur mundësi më të mëdha për zhvillimin ekonomik të komunës. Komuna në mënyrë aktive ka kërkuar mënyra për ta zgjeruar bazën e të hyrave vetjake dhe për përmirësimin e mbledhjes së këtyre të hyrave. Duhet cekur se MF-i i ka caktuar caqet – limitet e arkëtimit të tatimit në pronë.

Shpenzimet

Shpenzimet totale në Komunë janë në përputhje me të hyrat e planifikuara dhe të pritura për vitet 2012-2014 duke u bazuar në vitet fiskal 2010-2011.

Gjatë kësaj kohe niveli i shpenzimeve në paga dhe mëditje është rritur për shkak të pagesave të lehonave, rritjes së pagave të shërbyesve civil, arsimit dhe shëndetësisë, edhe pse stafi ka mbetur i njëjtë, çka është më i lartë se parametrat e parashtruara nga FMN, që pozicioni i pagave dhe mëditjeve të sillet në mes të 25,00 % dhe 30,00, % nga buxheti total.

Programi i investimeve kapitale ka treguar rritje për vitin 2011 në krahasim me vitin paraprak, për shkak të rritjes së grandit qeveritar dhe planifikimit e të hyrave vetjake, edhe pse parashikimet e arkëtimit në vitin 2011 janë rritur.

Shpenzimet në mallra dhe shërbime janë rritur në vitin 2011. Kemi rritje në pozicionin e shërbimeve komunale, ndërsa tek subvencionet dhe investimet kapitale kemi rritje në krahasim me vitin paraprak

Ndihma e donatorëve për buxhetin

Grandet për mbështetjen e buxhetit janë mjete në dispozicion për mbështetjen e përgjithshme të buxhetit e jo për ndonjë qëllim specifik. Grandet që e mbështesin buxhetin janë përfshirë në shifrat e të hyrave, që janë përshkruar më poshtë. Këto grande kanë ofruar një ndihmë të konsiderueshme për mundësimin e rritjes së shpenzimeve të ndërlidhura me zhvillimin e qeverisë komunale.

Grandet e donatorëve nuk janë të përfshira në KAB-in vjetor, pasi që është e vështirë të parashikohen, si dhe koha e pranimit dhe e shpenzimit të mjeteve nuk varet nga politika qeveritare, andaj nuk janë të paraqitura si të hyra. Si pasojë e kësaj është ndryshuar përgatitja e buxhetit 2011 pas konsolidimit të Programit të Investimeve Publike (PIP).

Projeksionet fillestare të të hyrave buxhetore

Përderisa projeksionet e të hyrave buxhetore për vitet 2012 – 2014 janë zhvilluar në kontekst të kornizës afatmesme të strategjisë zhvillimore të komunës, e ato janë bazuar mjaft edhe në këshillat dhe në bashkërendim me palët kryesore të interesuara në Kosovë, siç kërkohet edhe me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënien

Parashikimet e të hyrave për periudhën 2012 - 2014 aktualisht nuk përfshijnë çfarëdo vlerësimi lidhur me mbështetjen e donatorëve për buxhetin. Këto janë përjashtuar pasi që nuk ka ndonjë zotim të qartë nga donatorët për ofrim të mbështetjes për buxhetin në këto vite.

Këtë po e paraqesim në formë tabelore; shih tabelën nr.1

Tabela 1. Projeksioni i të hyrave buxhetore 2012 – 2014 të Komunës

Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**
	Buxheti	Buxheti	Projeksioni	Projeksioni	Projeksioni
KK – Rahovec	**8.222.829.00**	**9.513.658,00**	**9.362.487.00**	**9.504.851.00**	**9.605.646.00**
Të hyrat nga grandi qeveritar	7.309.101.00	8.798.158,00	8.548.487,00	8.675.851.00	8.757.146.00
Të hyrat vetjake	854.728.00	655.500,00	754.00.00	769.000.00	788.500.00
Participimi në shëndetësi	50.000.00	50.000,00	50.000.00	50.000.00	50.000.00
Të hyrat në arsim	**9.000.00**	**10.000.00**	**10,000,00**	**10.000.00**	**10.000.00**
Totali i të hyrave vetjake	**913.728.00**	**715.500,00**	**814.000.00**	**829.000.00**	**848.500.00**

Të hyrat nga Grandi Qeveritar

Të hyrat nga Grandi Qeveritar për vitin 2012-2014 kanë pasur rritje për këtë arsye edhe e kemi përgatitur KAB-in komunal me atë rritje. Kemi planifikuar që do të ketë rritje nga viti në vit. Në këtë rritje jemi bazuar në rritje e grandit qeveritar që ka pasur për viteve paraprake.

	Plani buxhetor 2011	Plani buxhetor 2012	Vlerësimet buxhetore 2013	Vlerësimet buxhetore 2014
Financimi total, nga i cili:				
Grandi i përgjithshëm	**3.030.339.00**	**3.201,286.00**	**3.328,650.00**	**3.409,945.00**
Grandi për Arsim	**4.698.529.00**	**4,287,739.00**	**4,287,739.00**	**4,287,739.00**
Grandi për shëndetësi	**1.069.290.00**	**1,059,462.00**	**1,059,462.00**	**1,059,462.00**
Gjithsej të hyrat vetjake	**715.500.00**	**814,000.00**	**829,000.00**	**848,500.00**
Gjithsej shpenzimet	**9.513.658.00**	**9,362,487.00**	**9,504,851.00**	**9,605,646.00**

Të hyrat vetjake të komunës

Të hyrat vetjake të Komunës pritet të rriten në një shkallë që tejkalon mjaft rritjen ekonomike. Projeksioni përfshin shumën e zbritur për disa përmirësime në zbatimin e tatimit në pronë. Vlen të përmendet që ka mjaft hapësirë për sigurimin e përmirësimeve në potencialin e të hyrave vetjake. Ndër faktorët që do të mund të ndikojë në rritjen e të hyrave nga tatimi në pronë gjatë viteve të ardhshme, janë edhe politikat fiskale që janë bërë në Komunë. Të hyrat nga tarifat e ngarkesat tjera që grumbullohen nga Komuna, pritet të rriten në linjë progresive me rritjen ekonomike.

Planifikimi i të hyrave

Burimi i të hyrave	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Totali i buxhetit	**9.513.658,00**	**9.362.487,00**	**9.504.851,00**	**9.605.646,00**
Të hyrat nga Granti qeveritar	**8.798.158,00**	**8.548.487,00**	**8.675.851,00**	**8.757.146,00**
Granti i përgjithshëm	3.030.339,00	3.201.286,00	3.328.650,00	3.409.945,00
Grani i shëndetësisë	1.069.290,00	1.059.462,00	1.059.462,00	1.059.462,00
Granti i arsimit	4.698.529,00	4.287.739,00	4.287.739,00	4.287.739,00
Të hyrat vetanake	**715.500,00**	**814.000,00**	**829.000,00**	**848.500,00**
Drejtoria për Financa dhe Buxh	**327.000,00**	**376.000,00**	**379.000,00**	**381.000,00**
Tatimi në pronë	180.000,00	210.000,00	210.000,00	210.000,00
Taksa në biznes	32.000,00	35.000,00	37.000,00	38.000,00
Qiraja	35.000,00	41.000,00	42.000,00	43.000,00
Taksa e regjistrimit të automjetev	80.000,00	90.000,00	90.000,00	90.000,00
Drejtoria për Administratë	**47.000,00**	**59.000,00**	**64.000,00**	**69.000,00**
Taksa nga pjesmarrja në tender	8.000,00	10.000,00	10.000,00	10.000,00
Taksa nga çertifikatat e ndryshme	18.000,00	22.000,00	24.000,00	26.000,00
Taksat administrative	18.000,00	22.000,00	24.000,00	26.000,00
Taksa nga fotokopja e dokumente	3.000,00	5.000,00	6.000,00	7.000,00
Drejtoria për Ekonomi	**14.000,00**	**18.000,00**	**20.000,00**	**21.000,00**
Taksa nga licencat e lokale	8.000,00	10.000,00	11.000,00	11.000,00
Taksa nga ptanimi teknik I lokalit	6.000,00	8.000,00	9.000,00	10.000,00
Drejtoria për KRS	**2.000,00**	**3.000,00**	**3.000,00**	**3.000,00**
Pagesa e bibliotekës dhe sallës	2.000,00	3.000,00	3.000,00	3.000,00
Drejtoria për Urbanizëm	**64.000,00**	**76.000,00**	**76.000,00**	**80.000,00**
Taksa nga lejet e ndërtimit	40.000,00	46.000,00	45.000,00	46.000,00
Taksa nga shfytlzimi i pronës kom	15.000,00	20.000,00	21.000,00	23.000,00
Respektimi I planit urbanisti	9.000,00	10.000,00	10.000,00	11.000,00
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kada	**59.000,00**	**62.000,00**	**65.000,00**	**67.000,00**
Taksa nga regjistrimi i pronës	32.000,00	34.000,00	35.000,00	36.000,00
Taksa nga gjeodezia (aktiv-matje	27.000,00	28.000,00	30.000,00	31.000,00
Transferi i pronës dhe Hioteka				
Drejtoria e Inspekcionit	**2.000,00**	**3.000,00**	**3.000,00**	**3.000,00**
Taksa nga dënimet mandatore	2.000,00	3.000,00	3.000,00	3.000,00
Drejtoria për Bujqësi	**12.500,00**	**22.000,00**	**24.000,00**	**27.000,00**
Taksa nga ndrimi i destina.të tokë	7.000,00	6.500,00	7.000,00	8.000,00
Taksa nga lemi i bujqes.e Ambien	5.500,00	4.500,00	5.000,00	6.000,00
Qiraja e tokes bujqesore		3.000,00	3.000,00	3.000,00
Taksa nga licen.i zhavor.e gurëthyes		8.000,00	9.000,00	10.000,00
Drejtoria për mbrojtje dhe sigur	**128.000,00**	**135.000,00**	**135.000,00**	**137.500,00**
Gjobat në tafik	50.000,00	55.000,00	55.000,00	57.500,00
Gjobat e gjykates	78.000,00	80.000,00	80.000,00	80.000,00
Arsimi	**10.000,00**	**10.000,00**	**10.000,00**	**10.000,00**
Taksa e pagesë në arsimi	10.000,00	10.000,00	10.000,00	10.000,00
Shëndetësia	**50.000,00**	**50.000,00**	**50.000,00**	**50.000,00**
Taksa nga participimi në shëndet	50.000,00	50.000,00	50.000,00	50.000,00

Politikat për rritjen e të hyrave

Është e njohur që në disa aspekte dhe si pjesë e procesit të zhvillimit komunal, sistemi i caktimit të taksave dhe tarifave, ashtu siç është duke u zhvilluar në Komunë, kërkohen përmirësime në koordinimin më të mirë në mes institucioneve relevante, të të hyrave që merren me vjeljen e tyre me theks të veçantë drejtoritë që merren me arkëtimin e të hyrave Komunale. Posaçërisht duhet të jenë të koordinuara me drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pasi ajo në strukturë përfshinë 40 % të hyrave totale të Komunës.

Grumbullimi i taksave të papaguara që janë akumuluar gjatë viteve të fundit, do të jenë në fokus të aktiviteteve të ndërmarra nga Komuna e posaçërisht Zyra e tatimit në pronë, në kontekst të përmirësimit, si të disiplinës së vjeljes së këtyre të hyrave, ashtu edhe në zgjerimin e numrit të tatimpaguesve.

Aktualisht është duke u marrë parasysh zhvillimi i masave të ardhshme legjislative që do të mbështesin arritjen e përmirësimit të të hyrave në bazë të projeksioneve. Në të njëjtën kohë, vlerësimet e efektit të të hyrave sipas masave që lidhen me to, do të përgatiten me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të tyre.

Tabela e më poshtme ofron projeksionin e elementeve kryesore të KAB-it Komunal për periudhën e planifikimit të buxhetit 2012 - 2014, përfshirë këtu të hyrat, shpenzimet dhe financimin, në bazë të vlerësimit të të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2010 dhe tre mujorin e parë të vitit 2011.

Tabela 2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2012 deri 2014.

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
	Buxheti	Buxheti	Projeksioni	Projeksioni	Projeksioni
KK – Rahovec	**8.222.829.00**	**9,513,658,00**	**9.362.487.00**	**9.504.851.00**	**9.605.646,00**
Paga dhe mëditje	4.016.514.00	5,130,263,00	5,342,890,00	5,350,422,00	5,354,950,00
Mallra dhe shërbime	631.671.00	674,947,00	786,737,00	793.271.00	796.941.00
Shërbime komunale	268.190.00	268,712,00	299,050,00	303.150.00	305.150.00
Subvencione e bartje	120.000.00	123,764,00	122,000,00	124.000.00	126.000.00
Shpenzime kapitale	3.186.454.00	3,315,972,00	2,811,810,00	2.934.008.00	3.022.605.00
Kerkesat			**11.387.752.00**	**12.060.003.00**	**13.191.826.00**

Tabela 2 Burimet e financimit të shpenzimeve sipas KAB-it 2012-2014

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
	Buxheti	Buxheti	Projeksioni	Projeksioni	Projeksioni
Grandi qeveritar	**7.309.101.00**	**8,798,158,00**	**8.548.487.00**	**8.675.851.00**	**8.757.146.00**
Pagat e mëditjet	3.976.514.00	5,090,263,00	5,302,890,00	5.310.422.00	5.314.950.00
Mallrat e shërbimet	612.671.00	654,947,00	766.737.00	773.271.00	776.941.00
Shërbimet komunale	268.190.00	268,712,00	299.050.00	303.150.00	305.150.00
Shpenzimet kapitale	2.451.726.00	2,784,236,00	2.179.810.00	2.289.008.00	2.360.105.00
Të Hyra vetjake	**913.728.00**	**715,500,00**	**814.000.00**	**829.000.00**	**848.500.00**
Pagat e mës. (shend)	40.000.00	40,000,00	40,000,00	40.000.00	40.000.00
Subvencionet e trans.	120.000.00	123,764,00	122.000.00	124.000.00	126.000.00
Shpenzimet kapitale	734.728.00	531,736.00	632.000.00	645.000.00	662.500.00
Mallra e shërbime	19.000.00	20,000,00	20,000,00	20.000.00	20.000.00
Donacionet			**2.025.265.00**	**2.555.152.00**	**3.585.180.00**
Totali i buxhetit	**8.222.829.00**	**9,513,658,00**	**9.362.487.00**	**9.504.851.00**	**9.605.646.00**

Strategjia e shpenzimeve buxhetore 2012 deri 2014

Qëllimi i këtij seksioni është të ofrojë një theks me disa diskutime për ato supozime që mbështesin projeksionin e linjës bazë 2012 – 2014, të kategorive të gjera ekonomike të shpenzimeve buxhetore. Projeksionet janë të bazuara në strukturën ekzistuese të sektorit publik dhe legjislacionin aktual.

Si pjesë e procesit zhvillimor të KAB-it, Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me Stafin Legjislativ dhe Ekzekutiv, ka bërë vlerësime paraprake 2012 – 2014 për buxhetin e komunës. Ky vlerësim do të paraqitet në tabelat në vijim, e që tregon vlerësimet aktuale të hershme, që paraqesin koston e vazhdimit të programeve

ekzistuese dhe projekteve. Këto vlerësime të hershme janë bazuar në buxhetin e aprovuar 2010-2011 bashkë me informatat që janë në dispozicion nga Departamenti i Buxhetit pranë MF-it.

Këto vlerësime të hershme do të paraqiten në tabelat në vijim;

Tabela 3. Vlerësimet e hershme të projekteve 2012 – 2014

	Buxheti	Buxheti	Vlerësimet e hershme		
Kategoria	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**
Paga dhe mëditje	4.016.514.00	5,130,263,00	5,342,890,00	5.350.422.00	5.354.950.00
Mallra dhe shërbime	631.671.00	674,947,00	786,737,00	793.271.00	796.941.00
Shërbimet komunale	268.190.00	268,712,00	299,050,00	303.150.00	306.150.00
Subvencionet e bartjet	120.000.00	123,764,00	122,000,00	124.000.00	126.000.00
Shpenzimet kapitale	3.186.454.00	3,315,972,00	2,811,810,00	2.934.008.00	3.022.605.00
Totali i buxhetit Komunal	**8.222.829.00**	**9,513,658,00**	**9,362,487,00**	**9,504,851,00**	**9,605,646,00**

PS 11.387.752.00-9.362.487.00= 2.025.265.00 2012 DONACIONET E JASHTME
PS 12.060.003.00-9.504.851.00= 2.555.152.00 2013 DONACIONET E JASHTME
PS 13.191.826.00-9.605.646.00= 3.586.180.00 2014 DONACIONET E JASHTME

Buxheti 2012– 2014 do të zhvillohet me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme. Këto vlerësime të hershme janë përgatitur për buxhetin e komunës.

Tabela në vijim tregon për ndryshimet që duhen bërë në vlerësimet e hershme, siç është niveli i shpenzimeve të përcaktuar në KAB-in komunal. Këto caqe mund të realizohen në bashkëpunim MF-in dhe duke i identifikuar masat e nevojshme që duhet të ndërmerren në mënyrë që ndryshimet në vlerësimet e hershme të përshtaten me caqet e KAB--it në secilën kategori shpenzuese.

Masat kryesore të nevojshme janë:

- Inkurajimi i taksapaguesve për kryerjen e obligimeve ndaj komunës,
- Krijimi i disiplinës në punë,
- Stimulimi i punëtorëve për punët e kryera me sukses dhe në afat
- Menaxhimi të jetë më i mirë tek arkëtimi i të hyrave vetjake dhe
- Krijimi i një kuadri profesional.

Tabela 4. Ndryshimet në vlerësimet e hershme që kërkohen për arritjen e caqeve të KAB-it Komunal 2011-2014

	Buxheti	Mjetet e kërkuara buxhetore		
Kategoria	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**
Paga dhe mëditje	0,00	212.627.00	7.532,00	4.528,00
Mallra dhe shërbime	0,00	111.790.00	6.53400	3.670,00
Shërbimet komunale	0,00	30.338.00	4.100,00	2.000,00
Subvencionet e bartjet	0,00	-1.764,00	2.000,00	2.000,00
Shpenzimet kapitale	0,00	-504.162,00	122.198,00	88.597,00
Totali i buxhetit Komunal	**0,00**	**-151.171,00**	**142.364.00**	**100.795,00**

Shpenzimet operative komunale dhe shpenzimet kapitale për 2012-2014

Në nivel komunal, shpenzimet potenciale janë kufizuar në lartësinë e shumës së grandit qeveritar dhe në nivelin e të hyrave vetjake.

Shpenzimet komunale pritet të shënojnë një rritje modeste gjatë periudhës buxhetore, të drejtuara kryesisht nga rritjet e parashikuara në të hyrat vetjake komunale. Kjo pasqyron dëshirën që komunat të zgjerojnë grumbullimin e të hyrave vetjake, e në veçanti përmes përmirësimit në grumbullimin e tatimit në pronë.

Plani i mësipërm buxhetor për shpenzimet kapitale për vitin 2012 përfshin grandin qeveritar, si dhe planifikimi i të hyrave vetjake si më të larta.

Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik
Pagat dhe mëditjet

Gjatë procesit të përpilimit KAB-it Komunal për periudhën buxhetore 2012-2014, Komuna ka caktuar një **rritje** në këtë kategori të shpenzimeve dhe atë në vlerë prej **212,627,00 €** për vitin 2012 më krahasim me vitin 2011, ndërsa për vitin 2013, në krahasim me vitin paraprak **rritja** është **7,532,00 €,** për vitin 2014 në krahasim me vitin paraprak (2013) **rritja** e planifikuar në këtë kategori është **4,528,00 €.**

Mallrat dhe Shërbimet

Për vitin 2012 kemi rritje të shpenzimeve në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve, në vlerë prej **111.790.00 €,** ndërsa për vitet e tjera, po ashtu në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve për periudhën e ardhshme sipas KAB-it komunal 2012-2014, kemi rritje për vitin 2013 në vlerën **6,534,00 €,** ndërsa për vitin 2014 kemi rritje prej **3,670,00 €.**

Shërbimet komunale

Në pozicionin e shpenzimeve komunale kemi rritje për vitin 2012 prej **30,338,00 €**, ndërsa për vitet e tjera, rritja sipas KAB-it Komunal është si vijon.

Për vitin 2013 rritja do të jetë **4,100,00 €,** ndërsa për vitin 2014 deri në **2,000,00 €.**

Subvencionet dhe Bartjet

Në këtë kategori të shpenzimeve sipas KAB-it Komunal kemi një zbritje në krahasim me vitin paraprak, në shumë prej **-1,764,00 €** për vitin 2012, ndërsa për vitin 2013 **2,000,00 €, e** për vitin 2014 **2,000,00 €**

Shpenzimet kapitale

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale kemi një rritje më të madhe krahasuar me vitet bazë, e që janë vitet 2010 – 2011. Këtu duhet cekur se në masë më të madhe këto shpenzime financohen nga të hyrat vetjake të Komunës. Duke marrë për bazë se në vitet e ardhshme planifikojmë ta rrisim disiplinën fiskale në arkëtimin e të hyrave vetjake, me theks të veçantë në arkëtimin e tatimit në pronë, e që është burimi kryesor i të hyrave vetjake, për këtë arsye kemi planifikuar edhe rritjen e këtyre shpenzimeve.

Për shkak të mjeteve të kufizuara për financimin e projekteve kapitale nga buxheti komunal, jemi duke bërë orvatjet e duhura të kërkimit të burimeve shtesë të financimit për projektet e mëdha kapitale, por ato do të përfshihen në formularët PIP – it, e që do të dorëzohen në MF. Aty do të ceken edhe burimet nga të cilat presim të

financohen. Zbritje në këtë pozicion për vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, kemi prej -**504,162,00 €,** ndërsa për vitet vijuese rritja është, për vitin 2013 **122,198,00 €,** ndërsa për vitin 2014 kemi rritje prej **88,597,00 €.**

Në fund duhet cekur se në total kemi planifikuar një rritje të buxhetit dhe atë si vijon më poshtë;

- Totali i buxhetit ka zbritje në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011 në shumë prej **-151,171,00 €**
- Totali i buxhetit ka rritje në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012 në shumë prej **142,364,00 €**
- Totali i buxhetit ka rritje në vitin 2014 në krahasim me vitin 2013 në shumë prej **100,795,00 €.**

Shënimet përmbyllëse

KAB-i, në mënyrën se si është parashtruar, ofron projeksion të burimeve dhe shpenzimeve buxhetore nga buxheti i Komunës (duke mos i përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve), nuk paraqet një reflektim të vlerësimit në mënyrë të plotë të kërkesave financiare nga agjencitë shpenzuese, për shkak burimeve të kufizuara. Sidoqoftë, prezantimi i mësipërm nuk identifikon kapacitetin e Buxhetit të Komunës për financimin e nevojave të veta, duke shfrytëzuar resurset e brendshme që janë në dispozicion. Është me rëndësi të planifikohet buxheti në bazë të kësaj, marrë parasysh pasigurinë rreth kohës dhe shumës së mbështetjes nga jashtë, që mund të vihet në dispozicion. Është veçmas e domosdoshme të bëhen planifikimet në këtë bazë, duke marrë parasysh kufizimet që Komuna ka për nevojat veta.

Tabela e Shpenzimeve sipas programeve dhe kodeve ekonomike për vitin 2012

Programi/Drejtoria	Stafi	Paga dhe meditje	Mallra dhe sherbime	Sherbime komuna	Subvencione dhe transfere	Shpenz. Kapitale	Totali
Z. E Kryetarit	12	83.774,00	35.620,00	0,00	80.000,00	0,00	199.394,00
Kuvendi	0	98.054,00	7.576,00	0,00	0,00	0,00	105.630,00
Administrata	51	175.082,00	36.200,00	0,00	0,00	120.000,00	331.282,00
Buxhet e Financa	15	67.958,00	30.400,00	0,00	0,00	16.000,00	114.358,00
Ekonomia	6	23.812,00	18.650,00	0,00	0,00	130.000,00	172.462,00
Kulturë,Rini, Sport	12	42.920,00	23.100,00	0,00	42.000,00	200.000,00	308.020,00
Urbanizmi	8	40.905,00	14.200,00	0,00	0,00	130.000,00	185.105,00
Gjeod.Kadast.	12	51.058,00	13.040,00	0,00	0,00	15.000,00	79.098,00
Inspekcioni	12	51.158,00	16.070,00	0,00	0,00	20.000,00	87.228,00
Bujqesi	10	40.985,00	19.660,00	0,00	0,00	400.000,00	460.645,00
Sherbime publike	26	124.988,00	32.450,00	175.000,00	0,00	1.449.982,00	1.782.420,00
ZLK	7	29.025,00	17.720,00	2.900,00	0,00	80.000,00	129.645,00
Qendra sociale	15	67.319,00	11.345,00	3.850,00	0,00	0,00	82.514,00
Shëndetësia	129	668.612,00	171.036,00	37.300,00	0,00	150.000,00	1.026.948,00
Performanca	0	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Arsim administr	9	43.200,00	37.128,00	0,00	0,00	100.828,00	181.156,00
Parafillor	8	24.960,00	13.500,00	4.000,00	0,00	0,00	42.460,00
Arsimi fillor	676	2.970.480,00	234.130,00	59.100,00	0,00	0,00	3.263.710,00
Arsimi mesem	153	738.600,00	54.912,00	16.900,00	0,00	0,00	810.412,00
Totali	**1161**	**5.342.890,00**	**786.737,00**	**299.050,00**	**122.000,00**	**2.811.810,00**	**9.362.487,00**

Plani i shpenzimeve sipas drejtorive 2012 – 2014

Programi	Plani buxhetor 2012	Struktura buxhetore 2012 në %	Vlerësimi 2013	Vlerësimi 2014
Z. E Kryetarit	199.394,00	**2,13**	202.775,00	204.855,00
Kuvendi	105.630,00	**1,13**	107.104,00	107.450,00
Administrata	331.282,00	**3,54**	338.420,00	344.200,00
Buxhet e Financa	114.358,00	**1,22**	104.625,00	111.950,00
Ekonomia	172.462,00	**1,84**	143.172,00	144.214,00
Kulturë,Rini, Sport	308.020,00	**3,29**	308.500,00	233.872,00
Urbanizmi	185.105,00	**1,98**	155.982,00	156.354,00
Gjeod.Kadast.	79.098,00	**0,84**	85.514,00	91.322,00
Inspekcioni	87.228,00	**0,93**	69.254,00	90.252,00
Bujqesi	460.645,00	**4,92**	411.312,00	412.302,00
Sherbime publike	1.782.420,00	**19,04**	2.040.868,00	2.170.185,00
ZLK	129.645,00	**1,38**	130.125,00	131.490,00
Qendra sociale	82.514,00	**0,88**	82.514,00	82.514,00
Shëndetësia	1.026.948,00	**10,97**	1.026.948,00	1.026.948,00
Performanca	-	**0,00**	-	-
Arsim administr	181.156,00	**1,93**	181.156,00	181.156,00
Parafillor	42.460,00	**0,45**	42.460,00	42.460,00
Arsimi fillor	3.263.710,00	**34,86**	3.263.710,00	3.263.710,00
Arsimi mesem	810.412,00	**8,66**	810.412,00	810.412,00
Totali	**9.362.487,00**	**100,00**	**9.504.851,00**	**9.605.646,00**

PLANI AFATMESËM KOMUNAL PËR INVESTIMET KAPITALE 2012-2014

Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë

Nr	*Kodi*	*Kodi i Program.*	**Emërtimi i projektit**	**2012**	**2013**	**2014**
1			Merematimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, Fshat-Qytet	**20.000,00€**	**70.000,00€**	**90.000,00€**
2			Ndriçimi publik në Rahovec dhe fshatra(Merematim, rregullim dhe mirëmbajtje)	**40.000,00€**	**35.000,00€**	**80.000,00€**
3			Rregullimi i trotuareve në rrugën kryesore në Xërxë	**20.000,00€**	**30.000,00€**	
4			Trotuaret në rrugën "Gëzim Hamza" në Rahovec		**45.000,00€**	
5			Kanalizimi në Senoc	**20.000,00€**	**40.000,00€**	
6			Ndërtimi i rrugës afër Parkut në Rahovec- Rr. "28 Nëntori"	**40.000,00€**	**50.000,00€**	
7			Kanalizimi në Reti (faza e dytë)	**40.000,00€**		
8			Rruga Unazore (Transite) mbi Rahovec - faza e parë	**150.000,00€**	**350.000,00€**	**420.000,00€**
9			Kanalizimi në fshatrat Potoçan i Ulët dhe Potoçan i Epërm	**65.000,00€**	**80.000,00€**	
10			Ndërtzimi i kanalizimit në fshatin Zatriq	**20.000,00€**		
11			Kamioni për zjarrfikës	**50.000,00€**		**50.000,00€**
12			Furnizim me kuba betoni me pjesëmarrje të qytetarëve	**30.000,00€**	**50.000,00€**	**200.000,00€**
13			Merematimi dhe mirëmbajtja e kanalizimit, furnizim, pjesëmarrje fshat-qytet	**50.000,00€**	**70.000,00€**	**150.000,00€**
14			Rregullimi i parkut për piknik në bjeshkën e Rahovecit	**10.000,00€**	**70.000,00€**	**20.000,00€**
15			Rregullimi i rrugës Pastasel-Kaznik- faza e parë	**50.000,00€**	**100.000,00€**	**200.000,00€**
16			Rruga Apterushë - Reti	**55.000,00€**	**40.000,00€**	
17			Asfaltimi i rrugës në Malësi të Vogël (qendër - hekurudhë)	**30.000,00€**		
18			Rruga Fortesë - Celinë (faza e parë)	**50.000,00€**	**100.000,00€**	**150.000,00€**
19			Tabelat me emrat e rrugëve, institucioneve, shesheve etj.	**10.000,00€**	**15.000,00€**	**20.000,00€**
20			Sinjalizimi vertikal dhe horizontal dhe vendosja e pengesave nëpër rrugë	**10.000,00€**	**15.000,00€**	**20.000,00€**
21			Pajisje për zjarrfikës, vegla, uniforma dhe pajisje të tjera		**10.000,00€**	**20.000,00€**
22			Rregullimi dhe gjelbërimi i	**10.000,00€**	**60.000,00€**	**50.000,00€**

			sipërfaqeve publike në fshatra dhe qytet			
23			Ndërtimi i rrugës prej Sh.F. "Hamëz.Thaçi " - tunel (Xërxe)	**50.000,00€**		
24			Rregullimi i rrugës Reti - Reti e Ulët	**140.000,00€**	**150.000,00€**	
25			Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë dy sezoneve	**90.000,00€**	**95.000,00€**	**110.000,00€**
26			Kanalizimi në Dabidol	**40.000,00€**	**20.000,00€**	
27			Kanalizimi në Sapniq	**35.000,00€**	**20.000,00€**	
28			Rregullimi i përroit Duhllo në Rahovec	**55.000,00€**	**30.000,00€**	
29			Ndërtimi i rrugëve në Çifllak	**35.000,00€**	**20.000,00€**	**50.000,00€**
30			Gjetja e ujit të pijshëm për fshatrat Senoc dhe Pastasel	**20.000,00€**		
31			Kanalizimi në Brestoc	**40.000,00€**	**40.000,00€**	
32			Kanalizimi në Drenoc	**50.000,00€**		
33			Ndërtimi i rrugëve në Krushë të Madhe	**40.000,00€**	**40.000,00€**	
34			Rregullimi i rrugës "Agim Çelaj" në Rahovec	**60.000,00€**		
35			Kanalizimi në Hoçë të Vogël	**40.000,00€**		
36			Rruga Vrajakë - Drenoc	**50.000,00€**	**60.000,00€**	
37			Merematimi dhe mirëmbajtja e banesave kolektive		**40.000,00€**	**100.000,00€**
38			Rregullimi i parkut në Rahovec-stadiumi i qytetit (projekt ideor)			**50.000,00€**
39			Uji i pijshëm për fshatrat Senoc dhe Pastasel	**55.000,00€**	**30.000,00€**	
40			Kanalizimi në Fortesë	**50.000,00€**	**30.000,00€**	
41			Ndërtimi i rrugës "Shkëlzen Zllanoga" në Rahovec	**30.000,00€**	**30.000,00€**	
42			Ndërtimi i rrugës "Sakip Bellaqa" në Rahovec	**50.000,00€**		
43			Ndërtimi i Kompleksit përkujtimor për dëshmorët e kombit	**60.000,00€**		
44			Ndërtimi i rrugëve në Ratkoc	**50.000,00€**	**30.000,00€**	**50.000,00€**
45			Kanalizimi në Vrajakë	**40.000,00€**		
46			Rregullimi i trotuareve në Kramavik	**20.000,00€**		
47			Ndërtimi i rrugës lokale në Celinë	**20.000,00€**	**30.000,00€**	**40.000,00€**
48			Kanalizimi në Bërtatin	**20.000,00€**	**20.000,00€**	
49			Rregullimi i rrugës Potoçan i Epërm - Nashpallë	**40.000,00€**		
50			Trotuari në rrugën e "UÇK"-së në Rahovec		**33.180,00€**	**50.000,00€**
51			Ndërtimi i rrugëve në Rahovec		**70.000,00€**	**150.000,00€**
52			Merematimi i rrugëve, trotuareve, shenjave	**15.000,00€**	**40.000,00€**	**70.000,00€**
53			Rregullimi i shesheve kryesore në qytet	**10.000,00€**		**6.777,00€**

			TOTALI :	**1.975.000,00€**	**2.058.180,00€**	**2.146.777,00€**	

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtja e Mjedisit

1			Mirëmbajtja e parqeve dhe mbrojtja e mjedisit	15.000,00€	15.000,00€	20.000,00€	
2			Mënjanimi i mbeturinave të ngurta,mbrojtja e mjedisit	15.000,00€	30.000,00€	30.000,00€	
3			Pastrimi i përrenjve dhe lumenjve	15.000,00€	15.000,00€	25.000,00€	
4			Hartimi i projekteve dhe mbikëqyrja	40.000,00€	45.000,00€	50.000,00€	
5			Mbjellja e drunjve dekorativ në qytet	10.000,00€	15.000,00€	20.000,00€	
6			Rregullimi i përroit (mbrojtja e burimit të ujit) në Apterushë		20.000,00€		
7			Rregullimi i përroit në Ratkoc	35.000,00€	20.000,00€		
8			Rregullimi i lumit në Fortesë				
			Totali	**130.000,00€**	**160.000,00€**	**145.000,00€**	

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

1		i	Mirëmbajtja e rrugëve fushore dhe hapja e rrugeve të reja.	80.000,00€	90.000,00€	100.000,00€	
2			Sistemi i ujitjes në fshatrat Krushë e Madhe, Nagac, H.e Vogël, Brestoc dhe H.e Madhe	20.000,00€	30.000,00€		Komuna 10%
3			Sistemi i ujitjes në fshatrat Zoçishtë dhe Apterushë	15.000,00€		30.000,00€	Komuna 10%
4			Kanali i kullimit i tokave bujqësore në fshatrat Ratkoc dhe Malësi e Vogël	25.000,00€		20.000,00€	Komuna 10%
5			Kanali i kullimit të tokave bujqësore në Celinë	15.000,00€			Komuna 10%
6			Mbjelljet pranverore(në bazë të kritereve)	20.000,00€	30.000,00€	60.000,00€	
7			Kanali i kullimit i tokave bujqësore në fshatrat Fortesë dhe Xërxë	10.000,00€	15.000,00€		
8			Tregu i gjelbër në Rahovec		20.000,00€		
9			Ndërtimi i objektit të sektorit të pylltarisë		15.000,00€		
			Totali	**185.000,00€**	**200.000,00€**	**210.000,00€**	

Drejtoria për Kulturë, Sport dhe Rini

1			Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Fortesë (faza e parë)	10.000,00 €	20.000,00€	30.000,00€
2			Përfundimi i fazës së tretë në	25.000,00 €		

			shtëpinë e kulturës në Ratkoc			
3			Pajisje për artefakte të ndryshme në fushën e trashëgimisë	10.000,00 €	15.000,00€	
4			Ndërtimi /rregullimi i shtëpisë Muze të Ukshin Hotit në Krushë të Madhe	40.000,00 €	20.000,00€	
5			Mbështetja e artit, kulturës dhe sportit(Pajisje, festivali "Anadrinia jehon", veshmbathje, etj)	25.000,00 €	30.000,00€	40.000,00€
			Totali	**110.000,00 €**	**85.000,00€**	**70.000,00€**

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

1			Rrethimi i objekteve në ZV	8.000,00 €		
2			Ndërtimi i ZV në Krushë të Madhe		25.000,00€	30.000,00
4			Ndërtimi i ZV në Drenoc	20.000,00 €		
5			Ndërtimi i ZV në Ratkoc		40.000,00€	30.000,00
6			ZV në Apterushë, përfundimi i projektit dhe rrethimi i objektit	15.000,00 €		
7			Blerja e autobusit për nevojat e Komunës	25.000,00 €		
8			Blerja e tetë veturave për nevojat e Komunës	40.000,00 €		
			Totali	**108.000,00 €**	65.000,00€	60.000,00

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

1			Instrumenti gjeodezik - Leica TCR 303	15.000,00 €		

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1			QMF -Ratkoc (vazhdim)	30.000,00 €	40.000,00€	
2			Ndërtimi i AMF-së në Xërxë	30.000,00 €	50.000,00€	20.000,00€
3			AMF në lagjen e epërme në Rahovec	20.000,00 €		20.000,00€
4			Meremetimi i objektit të QKMF-së në Rahovec	10.000,00 €		
5			Pajisje mjekësore speciale	10.000,00 €	20.000,00€	30.000,00€
6			Autoambulancë për QKMF dhe automjet për nevojat e DSHMS	30.000,00 €		40.000,00€
7			DSHMS, kujdesi primar shëndetësor(inventar për zyrë)	30.000,00 €	38.000,00€	40.000,00€

8			Ndërtimi i QMF-së në Brestoc-Hoçë e Vogël	20.000,00 €		
9			Ngritja e aneksit në QPS	10.000,00 €		
10			Rrethimi i oborreve të QMF-ve		42.000,00€	40.000,00€
				190.000,00 €	**190.000,00€**	**190.000,00€**

Drejtoria Komunale e Arsimit

1			Ndërtimi i shkollës fillore në Malësi të Vogël (faza e dytë)	80.000,00€	100.000,00€	150.000,00€
2			Mirëmbajtja dhe lyerja e shkollave	90.018,00 €	70.000,00€	80.000,00€
3			Mjete konkretizimi për shkolla	15.000,00 €	20.000,00€	25.000,00€
4			Meremetimi, fasada, lyerja e shkollës fillore në Nagac	5.000,00 €	10.000,00€	
5			Rrethimi dhe rregullimi i oborreve të shkollave në komunën e Rahovecit	42.000,00 €	45.000,00€	50.000,00€
6			Participimi me grandet e Bankës Botërore	2.500,00 €	3.000,00€	3.500,00€
7			Ndërtimi i shkollës në Kaznik (participim)	5.000,00 €	10.000,00€	
8			Kabinetet dhe furnizimi i bibliotekave shkollore	50.000,00 €		
9			Inventar	6.500,00 €	10.000,00€	10.000,00€
10			Nyje sanitare	30.000,00 €	30.000,00€	
11			Participimi në projektin /Renovimi i oborrit të shkollës"4 Dëshmorët" në Ratkoc	4.000,00 €	18.018,00€	
12			Participimi në projektet e fituara	6.000,00 €	20.000,00€	17.518,00€
			Totali	**336.018,00 €**	**336.018,00€**	**336.018,00€**

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

1			Fisibiliteti i Zonës Ekonomike, pjesa e KK Rahovec	10.000,00€	15.000,00€	20.000,00€
2			Hartimi i planeve zhvillimore, harta, skica dhe struktura të tjera (Turizmi)	10.000,00€	30.000,00€	40.000,00€
3			Rrugët e Verës-pjesëmarrja e komunës	30.000,00€		40.000,00€
4			Zhvillimi i turizmit	19.644,00€	30.000,00€	40.000,00€
			Totali	**69.644,00€**	**45.000,00€**	**60.000,00€**

Drejtoria për Financa dhe Buxhet

1			Ndërtimi i shtëpive për skamnorë	20.000,00€	70.000,00€	80.000,00€

TOTALI I INVESTIMEVE

Administrata	**2.612.644,00€**		
Shëndetësia	**190.000,00€**	**190.000,00€**	**190.000,00€**
Arsimi	**336.018,00€**	**336.018,00€**	**336.018,00€**
Totali:	**3.138.662,00€**	**3.209.198,00€**	**3.297.795,00€**